



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 28.02.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR
RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES PËR
BASHKËPUNIMIN TEKNIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE, TË
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL PËR SHQIPËRINË,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 66/2017”

• ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”, në mbledhjen e datës 28 shkurt 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputeten Eglantina Gjermeni relatore për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

• ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

• QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”, vjen si nevojë e amendimit të tekstit të marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për programin e zhvillimit rajonal, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017, datë 20.4.2017.

Marrëveshja e grantit e ratifikuar në vitin 2017, synon realizimin e objektivave të mëposhtme:

- forcimin e sistemeve institucionale të agjencive të zhvillimit, që do krijohen gjatë vitit të tyre të parë të funksionimit (ngritja e kapaciteteve, ngritja e institucioneve, qasjet nëpërmjet pjesëmarrjes);
- hartimi i programeve operacionale të zhvillimit rajonal;
- sigurimi i një qasjeje partneriteti, duke integruar qeverinë vendore, shoqërinë civile, sektorin privat në programimin, monitorimin dhe projektet e zhvillimit rajonal.

Programi për Zhvillimin Rajonal 3 që nisi më 1.4.2017, është duke u zbatuar në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare që prej vitit 2014.

Partnerët ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), me anë të komunikimit zyrtar kanë kërkuar, në fillim të muajit korrik 2018:

1. Përcaktimin e autoritetit bashkëpunues të programit. Duke qenë se, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, ishte Ministria e Zhvillimit Urban agjencia bashkëpunëtoe e projektit dhe partneri zbatues ECORYS dhe Co-PLAN. Në këtë aspekt marrëveshja ndryshuese parashikon që drejtimi i projektit të kryhet nga Zëvendëskryeministri për aspektet e lidhura me legjislacionin, politikën kombëtare për zhvillim dhe programimin kombëtar.
Gjithashtu, në kuadër të vënies në funksion të plotë të skemës institucionale të mekanizmit të zhvillimit rajonal, duke transferuar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit rolin e agjencive të zhvillimit rajonal, propozohet që Fondi Shqiptar i Zhvillimit të jetë në rolin e agjencisë bashkëpunuese të projektit.
2. Zgjatjen e afatit të zbatimit të projektit, nga afati aktual nga 30.9.2018 deri më 31.3.2019. Kjo zgjatje propozohet nga partnerët ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në vendimin e Komitetit Drejtues të RDP3, dhe konsiderohet një afat real, bazuar në rezultatet e deritanishme dhe ato të pritshme, të parashikuara.

Marrëveshja ndryshuese parashikohet të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kontributi financiar i palës zvicerane referuar tekstit të marrëveshjes bazë është parashikuar të jetë në formë granti në masën prej 3 445 000 CHF ndërkohë që pala shqiptare do të përballonte kostot e nevojshme për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në një shumë prej 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë) frangash zvicerane, të konvertuar në lekë. Kosto e TVSH-së përkatësisht vlerës së mbetur nga diferenca e totalit të TVSH-së me vlerën e disbursuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të ndryshimit të marrëveshjes, do të mbulohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

- ***Diskutimi në komision***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi këtë projektligj, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 28 shkurt 2019.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Të ftuarit shpjeguan se projektligji i propozuar vjen si nevojë e bërjes së disa ndryshimeve në tekstin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për zbatimin e projektit, e cila është në fazën e tretë të zbatimit të saj. Marrëveshja e bashkëpunimit, e miratuar me vendimin nr.263, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017, është duke u zbatuar në kuadër të reformës së zhvillimit rajonal, të ndërmarrë nga qeveria shqiptare që prej vitit 2014.

Ky projekt vjen si asistencë e partnerëve ndërkombëtarë, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në vazhdimësi të fazës paraardhëse PZHR2, të zbatuar nga qeveria shqiptare dhe të ndjekura nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, që mbulon edhe çështjet e reformës së zhvillimit rajonal, filluar nga qeveria, nën kujdesin e Kryeministrit, në vitin 2014.

Ndryshimet e propozuara në marrëveshje bëhen me qëllim ri përcaktimin e autoritetit bashkëpunues të programit, duke qenë se, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e bashkëpunimit, ishte Ministria e Zhvillimit Urban agjencia bashkëpunëtoare e projektit (pika 1 e nenit II) dhe partneri zbatues ECORYS dhe Co-PLAN, por, si pasojë e ndryshimeve në strukturën e qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017, në mungesë të MZHU-së, zyrtarisht nuk mbulohet roli i agjencisë bashkëpunëtoare; dhe ndryshimin e afatit të zbatimit të programit, nga 30.9.2018 deri më 31.3.2019, si nevojë e kohës për përfundimin e produkteve të tij.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan nismën e propozuar, kërkuan informacion mbi ecurinë e deritanishme të zbatimit të marrëveshjes për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë dhe diskutuan lidhur me nevojën për përmbushjen e objektivave të këtij projekti brenda datës së riskeduluar, 31.3.2019.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETAR

Eglantina GJERMENI

Niko PELESHI